



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.5/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit D.N, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga Kryesia e Degës Regjionale të Odës së Avokatëve në Pejë përmes Kryetarit të saj avokatit B.A, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 17.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga Kryesia e Degës Regjionale të Odës së Avokatëve në Pejë përmes Kryetarit të saj avokatit B.A, ndaj gjyqtarit D.N, **SI E PABAZUAR**.

A r s y e t i m

Me datë 15.05.2024, Kryesia e Degës Regjionale të Odës së Avokatëve në Pejë përmes Kryetarit të saj avokatit B.A, ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit D.N, me arsyetimin se gjyqtari ka treguar sjellje joprofesionale, kolegjiale dhe morale ndaj veteranit të avokatisë, avokatit G.K, nga Peja, pasi ka përdorë terma ofenduese që nuk përkohjnë me pozitën e tij dhe me ton të lartë i është drejtuar avokatit me fjalët “delem prej zyrës” dhe me fjalë të tjera fyese, e cila sjellje dëmton rëndë reputacionin gjyqësor, denigron dhe ulë integritetin personal të avokatit në fjalë dhe mundohet të ulë edhe dinjitetin e avokatisë, me këtë gjyqtari ka vepruar në kundërshtim me pikën 4 të Kodit të Etikës për Gjyqtar ku shprehimisht ceket se “gjyqtari duhet të sillet me integritet ... dhe nuk duhet të përdorë gjuhë të urrejtjes apo të ketë sjellje të pahijshme apo të vrazhdë”, andaj ka propozuar që menjëherë të veprohet konform Ligjit nr. 06/L-057 me qëllim që në të ardhmen të mos përsëriten sjelljet e njëjta ndaj avokatëve, pasi nuk është hera e parë që gjyqtari sillet në këtë mënyrë me avokatët.

Me datë 15.05.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga Kryesia e Degës Regjionale të Odës së Avokatëve në Pejë përmes Kryetarit të saj avokatit B.A, ndaj gjyqtarit D.N.

Gjyqtari D.N, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit së ankesës ka theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e parashtruara në ankesë disiplinore, duke theksuar se si gjyqtar gjatë përmbushjes së detyrave publike, respekton në tërësi parimin thelbësor të drejtësisë – parimin e mos komunikimit me palë duke mos qenë prezent pala tjetër (ex partë), parim ky që detyrohen ta zbatojnë jo vetëm gjyqtarët por të gjitha palët e tjera procedurale. Në rastin konkret, gjyqtari ka theksuar se avokati G.K, pa pas ftesë për seancë, pa u lajmëruar paraprakisht në sportelin e gjykatës, ka hyrë në zyrën e gjyqtarit dhe ka kërkuar të konsultohet me të mirëpo, të njëjtit i ka thënë se është i zënë, pas kësaj avokati është larguar duke e lënë derën e zyrës të hapur edhe pse ishte e mbyllur para se ai të hynte në zyrë dhe duke qenë se e ka lënë derën hapur, ka kërkuar që t’ a mbyllë derën. Rrjedhimisht, gjyqtari ka shtuar se pretendimet e paraqitura në ankesë se ka përdorë fjalë fyese dhe ofenduese ndaj avokatit, nuk qëndrojnë dhe të njëjtat janë

tendencë e hapur për cenimin e pavarësisë së gjyqtarit në ushtrimin e funksionit të tij dhe mjet për shmangien e parimit të mos komunikimit me palë pa prezencën e palës tjetër, duke shtuar po ashtu se si gjyqtar respekton në tërësi të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve në procedurë, respekton parimin e kontradiktoritetit në një seancë të hapur dhe publike ku të gjitha palët kanë mundësi të deklarohen, mirëpo në të njëjtën kohë duke refuzuar diskutimet me palët pa pas seancë dhe pa praninë e palës tjetër.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit D.N, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore nuk është e bazuar.

Autoriteti kompetent në vlerësim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës se gjyqtari N. ka treguar sjellje joprofesionale, jokolegiale dhe jomorale pasi ka përdorë fjalë ofenduese dhe fyese dhe me ton të lartë i është drejtuar avokatit G.K me fjalët “delem prej zyrës”, ka gjetur se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara dhe të njëjtat ankuesi nuk i ka mbështetë me asnjë provë. Parashtruesi i ankesës, në përmbajtjen e parashtresës së tij, me asnjë provë nuk e ka argumentuar sjelljen joprofesionale të gjyqtarit, duke mos ofruar një përshkrim konciz të rrethanave të rastit, mirëpo vetëm duke parafrazuar se gjyqtari ka fyer dhe ofenduar avokatin Kelmendi, duke mos specifikuar fjalët ofenduese dhe fyese të përdorura nga gjyqtari përveç fjalës “delem prej zyrës”, përdorimi i së cilës fjalë megjithëse mbeti i pavërtetuar, si fjali e vetme e cituar të jetë përdorë nga gjyqtari drejtuar avokatit është e pamjaftueshme për t’u konsideruar se gjyqtari ka dëmtuar reputacionin gjyqësor, ka ulë integritetin e avokatit dhe mundohet të ulë dinjitetin e avokatisë në përgjithësi.

Përveç kësaj, në parashtresën e tij ankuesi ka ngritë pretendimet se nuk është hera e parë që gjyqtari silltet në këtë mënyrë me avokatët, pretendim ky i cili vetëm ngritët nga parashtruesi i ankesës dhe atë pa identifikuar asnjërin prej avokatëve të cilët supozohet se gjyqtari i ka ofenduar dhe pa e përshkruar se me cilat fjalë apo sjellje joprofesionale dhe jomorale i ka ofenduar dhe fyer avokatët gjyqtari në fjalë. Andaj, deklaratimet e tilla si të vetme, të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me asnjë provë nga ana e parashtruesit të ankesës, nuk mund të merren si bazë për inicimin eventual të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.5/24, me datë 17.05.2024.

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit D.N*
- 3. Parashtruesit të ankesës – B.A, avokat*

